



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/15
Datë: 23.03.2020

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 55, nenit 92, paragrafi 4 dhe nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 41 dhe nenit 44 të Ligjit nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, paragrafit 1.11 të Nenit 12 dhe nenit 89 të Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi, nenit 4 të Rregullores nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/11 datë 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2020, nxjerr këtë:


V E N D I M

Qeveria e Republikës së Kosovës aprovon kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë për ndërmarrjen e masave për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së virusit COVID-19 si në vijim:

1. Ndalohet qarkullimi i qytetarëve dhe automjeteve private nga 24 mars 2020 gjatë orës 10:00 - 16:00 dhe prej orës 20:00 - 06:00, përveç për nevoja mjeksore, prodhim, furnizim dhe shitje të mallrave esenciale (ushqim dhe barna për njerëz dhe kafshë/shpezë), dhe për shërbime dhe aktivitete që ndërlidhen me menaxhim të pandemisë (menaxhmenti dhe personeli esencial qeveritar dhe komunal nga këta sektorë: shëndetësi, siguri dhe administratë shtetërore).
2. Mundësohet qarkullimi i lirë për operatorët ekonomik të klasifikuar si me të rëndësishme sipas kodeve NACE që Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike lejon të operojnë në këtë periudhë emergjente lidhur me pandeminë COVID -19, si dhe transporti i lirë i mallrave/shërbimeve për të siguruar funksionimin e zinxhirit të furnizimit.
3. Lëvizjet në rrugë bëhen jo më shumë se nga dy persona së bashku dhe gjithmonë duke mbajtur distancën dy metra me të tjerët.
4. Ndalohen tubimet në të gjitha mjediset - private dhe publike, të hapura dhe të mbyllura - përveç kur është e domosdoshme për të kryer detyrat e punës për parandalim dhe luftim të pandemisë, si dhe ku lejohet distanca dy metra me të tjerët. Në rast të vdekjeve, në varrim mund të marrin pjesë vetëm anëtarët e ngushtë të familjes së të vdekurit dhe personat që kryejnë shërbimin e varrimit.
5. Obligohen Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/15
Datë: 23.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. I kërkohet Agjencisë Kosovare të Privatizimit të pezullojë për afat të pacaktuar të gjitha veprimet në lidhje me pronat e paluajtshme që ka nën administrimin.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Neni 5.3 i Ligjit 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra parasheh që "Agjencia merr parasysh të gjitha politikat përkatëse të cilat mund të miratohen nga Qeveria ose Kuvendi i Kosovës".

Programi i Qeverisë 2020-2023 parasheh politika që mund të ndryshojnë statusin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe të ndryshojnë administrimin afatgjatë të pronës publike dhe shoqërore (pikat 1.3.2 dhe 3.1.1). Veprimet e Agjencisë në lidhje me pronat që administrojnë mund të pengojnë përmbushjen e programit të Qeverisë.

Për këtë arsye, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Agjencisë Kosovare të Privatizimit



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/15
Datë: 23.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 55 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe të neneve 5, 7, 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Anulohen** këto vendime të Qeverisë lidhur me themelimin e Zonës Ekonomike në Komunën e Malishevës dhe shpronësimin e pronës së paluajshme:
 - 1.1. Vendim nr. 11/50 i 5 qershorit 2018;
 - 1.2. Vendim nr. 12/65 i 13 shtatorit 2018;
 - 1.3. Vendim nr. 13/81 i 24 dhjetorit 2018; dhe
 - 1.4. Vendim nr. 18/107 i 18 qershorit 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Me Vendimin nr. 11/50 të 5 qershorit 2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, e udhëhequr nga kryeministri Ramush Haradinaj, ka miratuar "shpalljen e zonës me interes të veçantë ekonomik me qëllim të themelimit të Zonës Ekonomike në Komunën e Malishevës". Sipas vendimit, zona ekonomike është paraparë të shtrihet në parcela të caktuara në zonat kadastrale Banjë, Bellanicë dhe Senik.

Për të mundësuar themelimin e zonës ekonomike në parcelat e cekura, Qeveria Haradinaj ka nxjerrë edhe tri vendime për shpronësimin e tyre:

- Vendim për të miratuar shqyrtimin e mëtejme për shpronësim, nr. 12/65 i 13 shtatorit 2018;
- Vendim preliminar për shpronësim, nr. 13/81 i 24 dhjetorit 2018;
- Vendim përfundimtar për shpronësim, nr. 18/107 i 18 qershorit 2019.

Por këto vendime nuk janë në përputhje me ligjin. Ligji nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike përcakton kushtet thelbësore për themelimin e tyre. Së pari, zona themelohet në përputhje me planin kombëtar për zonat ekonomike (neni 9 lidhur me nenin 5.4). Së dyti, zona themelohet në përputhje me planin hapësinor të komunës, që duhet harmonizuar me planin kombëtar për zonat ekonomike (nenet 8.3 dhe 9.1).

Së treti, zona themelohet vetëm pasi të kryhet një studim fizibiliteti, të mbahet një dëgjim publik dhe të arsyetohet themelimi i zonës (neni 7 lidhur me nenin 5.4). Së katërti, zona duhet të vendoset në pronën e themeluesit, ndonëse themeluesi mund të shpronësojë pronat e nevojshme për zonën (neni 9).

Koncept-plani kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike në Kosovës 2014–2018, si dokument i paraqitur nga ministria përgjegjëse për tregti e industri, parasheh themelimin e zonave ekonomike në Gjakovë dhe Mitrovicë. Kurse Malishevën nuk e përmend as edhe një herë të vetme. Pra, vendimi 11/50 nuk është në përputhje me planin kombëtar për zonat ekonomike, siç kërkon ligji.

Kur është marrë vendimi, Komuna e Malishevës nuk ka pasur plan zhvillimor komunal. Një plan i tillë është nxjerrë tek pas shpalljes së zonës me akt të Qeverisë. Rrjedhimisht, vendimi 11/50 s' është në përputhje me kërkesat ligjore të planifikimit.

Studim fizibiliteti ose dëgjim publik për Zonën Ekonomike të Malishevës nuk ka pasur. Me fjalë të tjera, nuk ka kurrfarë dokumenti që thotë pse duhet themeluar zona. Kësisoj, nuk janë plotësuar parakushtet ligjore për vendimin 11/50.

Për më tepër, ngastrat që Qeveria Haradinaj ka shënjuar për shpronësim janë prona private. Komuna fillimisht ka nxjerrë një listë me parcela të tjera për zonën ekonomike, porse lista është ndryshuar pashpjegueshëm para se t'i dorëzohet Qeverisë për miratim. Parcelat e shënuara përfshijnë toka që kanë qenë pronë shoqërore deri më 2009, kur janë privatizuar për rreth 10 euro ari. Sot ari është vlerësuar në 807 euro – gati njëqindfishi i çmimit blerës.

Në mungesë të një arsytimi, Qeveria e sotme e ka të pamundshme të kuptojë pse nuk janë shfrytëzuar pronat e shumta publike ose shoqërore në Komunën e Malishevës. Kështu del që përzgjedhja e parcelave ka qenë krejt e paarsyeshme dhe vendimet për shpronësimin e tyre krejt të panevojshme dhe në kundërshtim me Ligjin për zonat ekonomike.

Nga këto rrethana rrjedh që vendimi 11/50 për shpalljen e zonës ekonomike dhe vendimet vijuese 12/65, 13/81 dhe 18/107 për shpronësimin janë të paligjshme.

Ligji nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, i ndryshuar me ligjet 03/L-205 dhe 04/L-115, bën vendimet e shpronësimit akte administrative (nenet 11.11 dhe 39). Andaj, për katër vendimet e Qeverisë, vlejné rregullat e Ligjit nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative. Neni 55.1 LPPA i jep të drejtën organit shtetëror të anulojë një akt administrativ për të vendosur ligjshmërinë.

Rrjedhimisht, Qeveria është në të drejtën e saj të anulojë vendimet si në dispozitiv.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Komunës së Malishevës



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/15
Datë: 23.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Reformën Gjyqësore në Drejtësi Komerciale.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Koncept Dokumentit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/15

Datë: 23.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Sistemin Qëndror të Evidencës Penale të Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Koncept Dokumentit nga pika 1 e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/15
Datë: 23.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 46 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Vjetor Financiar për vitin 2019.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi ta dorëzoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës, konform nenit 46 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë